

**V E N D I M**  
**Nr.347, datë 23.5.1998**

**PËR SHKËPUTJEN NGA PUNA TË SUBJEKTEVE SPORTIVE PËR PËRGATITJEN  
DHE PJESËMARRJEN E TYRE NË VEPRIMTARITË SPORTIVE  
NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në subjektet sportive hyjnë sportistët, trajnerët, mjekët sportivë, gjyqtarët dhe vëzhguesit.

2. Subjektet sportive të punësuar në institucione ose ndërmarrje shtetërore, si dhe nxënësit e studentët e shkollave shtetërore e private, lejohen të shkëputen nga veprimtaria e përditshme për ditët që lidhen me përgatitjen dhe pjesëmarrjen e ekipeve kombëtare në veprimtaritë sportive brenda ose jashtë vendit.

Personat juridikë privatë, të lejojnë subjektet sportive të punësuar pranë tyre, për pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive pa të drejtë page.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, t’i paraqesë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës kalendarin e veprimtarive sportive brenda dhe jashtë vendit, kur subjektet sportive janë nxënës ose studentë.

3. Të punësuarit në institucione ose në ndërmarrje shtetërore pagën për këtë periudhë do ta marrin në institucionin përkatës, kurse të punësuarit në ndërmarrje ose institucione private në federatën që organizon veprimtarinë sportive.

4. Mungesat e nxënësve dhe studentëve, të shkaktuara nga grumbullimi për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive ndërkombëtare, konsiderohen të justifikuara dhe nuk përfshihen në numrin e përgjithshëm të tyre.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.188, datë 25.4.1995, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**